

"San Luca" Sh.P.K.

L82009018B

Rruga "e Kavajës", nr. 116, Tirana, Albania

Subscribed & Paid-In Capital: ALL 100.000,00

Nr. 5/2 Prot.

Tiranë më 25.01.2019

DEKLARATË
(për shitje kuote)

Unë, i nënshkruari

- **Z. Rezart Cenaj**, i biri i Lefterit, i datëlindjes 15.08.1979, lindur në Sazan, Vlorë dhe banues në Rruga "Him Kolli", nr. 56, Tiranë, mbajtës i kartës së identitetit me nr. H90815052F, ortak në masën **40% (dyzet për qind)** të kapitalit të nënshkruar të Shoqërisë San Luca SHPK, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar; ose

(në vijim referuar shkurt si "Shitësi")

Në cilësinë e ortakut të shoqërisë shoqërisë "**San Luca Sh.P.K.**", shoqëri e krijuar dhe që ekziston sipas legjislacionit shqiptar në fuqi, e regjistruar në Regjistrin Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NIPT L82009018B dhe me seli në adresën me seli në Rr. e Kavajës, Nr. 116, Tiranë Shqipëri, me kapital të regjistruar në vlerën 100.000,00 Lekë (më poshtë referuar si "**Shoqëria**"), nëpërmjet këtij akti deklaroj synimin tim për të shitur kundrejt vlerës 1 Euro ½ (gjysmën pjesë) e kuotës sime me të drejta votë në Asamblenë e Përgjithshme që zotëroj tek Shoqëria, kuotë kjo e barabartë me 40 % (dyzetë për qind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë dhe me vlerë nominale 40.000 (dyzet mijë Lekë).

Mbetem në pritje të njoftimit tuaj brenda afatit ligjor për ushtrimin e së drejtës së parablerjes.


Duke besuar në bashkëpunimin dhe mirëkuptimin tuaj,

Me respekt,


Z. Rezart Cenaj

ADMINISTRATORI


Z. Arminda Avdulaj

Rezart Cenaj


Konfirmon marrjen: j Arminda Avdulaj.

Arminda Avdulaj


Cenaj


Arminda Avdulaj


"San Luca" Sh.P.K.

L82009018B

Rruga "e Kavajës", nr. 116, Tirana, Albania

Subscribed & Paid-In Capital: ALL 100.000,00

Nr. __ Prot.

Tiranë më 25.01.2019

DEKLARATË

(për mos ushtrim të të drejtës së parablerjes)

Unë, e nënshkruara

- **Z. Armina Avdulaj**, shtetas shqiptare, e bija e Aleksandrit, lindur në Havanë, Kubë më 03.04.1989, banuese në rrugën "Grigor Heba" 40, 2/36, Tiranë, mbajtëse e kartës së identitetit nr. I95403063F, ortake në masën **60% (gjashtëdhjetë për qind)** të kapitalit të nënshkruar të shoqërisë San Luca SHPK (në vijim referuar shkurt si "ortaku mazhoritar")


Në cilësinë e ortakut të shoqërisë San Luca Sh.P.K., shoqërisë "**San Luca Sh.P.K.**", shoqëri e krijuar dhe që ekziston sipas legjislacionit shqiptar në fuqi, e regjistruar në Regjistrin Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NIPT L82009018B dhe me seli në adresën me seli në Rr. e Kavajës, Nr. 116, Tiranë Shqipëri, me kapital të regjistruar në vlerën 100.000,00 Lekë (më poshtë referuar si "**Shoqëria**"), në vijim të shkresës suaj datë 10.9.2018 ku na njoftoni në lidhje me synimin tuaj për të shitur ½ pjesë të kuotës që zotëroni në Shoqëri, ju informojmë se nuk synoj të ushtroj të drejtën e parablerjes, pasi nuk jemi të interesuar të blejmë këtë kuotë, të cilën Ju mund t'ia transferoni çdo pale të tretë, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Me respekt,


Zj. Armina Avdulaj


ADMINISTRATORI

Zj. Armina Avdulaj



Konfirmon marrjen: Z. Rezart Cenaj





“San Luca” Sh.P.K.

L.82009018B

Rruga “e Kavajës”, nr. 116, Tirana, Albania

Subscribed & Paid-In Capital: ALL 100.000,00

MARRËVESHJE PËR SHITJE KUOTASH

Në Tiranë, sot më datë 25.01.2019, lidhet kjo marrëveshje për shitje kuotash ndërmjet palëve si më poshtë vijon:

- **Z. Rezart Cenaj**, i biri i Lefterit, i datëlindjes 15.08.1979, lindur në Sazan, Vlorë dhe banues në Rruga “Him Kolli”, nr. 56, Tiranë, mbajtës i kartës së identitetit me nr. H90815052F, ortak në masën 40% (**dyzet për qind**) të kapitalit të nënshkruar të Shoqërisë San Luca SHPK, shoqëri e krijuar dhe që ekziston në përputhje me legjislacionin shqiptar, e regjistruar në Regjistrin Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NIPT L82009018B (më poshtë referuar si “Shoqëria”); (në vijim referuar si “**Shitësi**”);

dhe

- **Z. Dritan Aliaj**, i biri i Patriotit, shtetas shqiptar, i datëlindjes 15.01.1971, lindur në Vlorë dhe banues në Tiranë, në rrugën “Mujo Ulqinaku”, mbajtës i letërnjoftimit me numer personal H10115147P (në vijim referuar si “**Blerësi**”).

Më poshtë “**Shitësi**” dhe “**Blerësi**”, bashkërisht do të referohen dhe si “**Palët**” dhe individualisht dhe si “**Pala**”.

MEQENËSE:

- A. Shitësi zotëron një kuotë të barabartë me 40 % (dyzetë për qind) të kapitalit të regjistruar të shoqërisë “**San Luca Sh.P.K.**”, shoqëri e krijuar dhe që ekziston sipas legjislacionit shqiptar në fuqi, e regjistruar në Regjistrin Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NIPT L82009018B dhe me seli në adresën me seli në Rr. e Kavajës, Nr. 116, Tiranë Shqipëri, me kapital të regjistruar në vlerën 100.000,00 Lekë (më poshtë referuar si “**Shoqëria**”), që i akordon këtij ortaku të drejta të plota vote sipas legjislacionit shqiptar në fuqi;
- B. Shitësi ka informuar ortakun tjetër të Shoqërisë për synimin e tij për të shitur 1/2 e kuotës së tij, ose 20% të vlerës nominale të kapitalit që ai zotëron në Shoqëri, kundrejt një çmimi prej 1 (një) euro; dhe
- C. Blerësi nuk është ortak i Shoqërisë dhe as administrator dhe/ose punonjës i saj, por ka shprehur vullnetin e tij për të blerë kuotën e ofruar nga Shitësi.

Palët bien dakord si më poshtë vijon:

Neni 1

Objekti i Marrëveshjes

- 1.1 Shitësi i shet dhe i transferon 1/2 e kuotës Blerësit dhe Blerësi e blen dhe e disponon këtë pjesë të kuotës prej 20% të kapitalit të shoqërisë nga Shitësi sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në këtë Marrëveshje.

“San Luca” Sh.P.K.

L82009018B

Rruga “e Kavajës”, nr. 116, Tirana, Albania

Subscribed & Paid-In Capital: ALL 100.000,00

- 1.2 Kuota prej 20% të kapitalit do të transferohet menjëherë me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje nga Shitësi tek Blerësi dhe Blerësi do të bëhet pronar me të drejtë të plotë të një kuote në kapitalin e Shoqërisë, të barabartë me 20 % (njëzetë për qind) të kapitalit të Shoqërisë, me të drejtë vote sipas ligjit.

Neni 2

Çmimi i Shitjes

- 2.1 Çmimi i shitjes është 1 (një) euro.
- 2.2 Palët pranojnë se çmimi është paguar dhe Shitësi nuk ka asnjë pretendim financiar kundrejt Blerësit tani dhe/ose në të ardhmen në lidhje me të.

Neni 3

Deklarime dhe Garanci të Shitësit

- 3.1 Shitësi nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje deklaron dhe garanton Blerësin se:
- a) Shitësi ka zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar dhe zotëron të gjitha kompetencat në lidhje me nënshkrimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, si dhe lidhur me kryerjen e transaksionit të parashikuar në të; dhe
 - b) Shitësi zotëron Kuotën të lirë nga çdo hua, hipotekë, barrë siguroese, peng, marrëveshje kufizuese, kufizim të drejte transferimi apo marrëveshje për kufizimin e të drejtës së votës, apo çdo mjet tjetër ligjor që kufizon në ndonjë mënyrë të drejtën e pronësisë mbi kuotat.

Neni 4

Përgjegjësia e Shitësit

- 4.1 Shitësi është përgjegjës për çdo dëm të ndodhur në rast se deklaratimet dhe garancitë e parashikuara në Nenin 3 më sipër rezultojnë të pavërteta.

Neni 5

Të drejtat dhe detyrimet e Palëve

- 5.1 Palët gëzojnë të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në këtë Marrëveshjeje dhe ato që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi si rrjedhojë e lidhjes së kësaj Marrëveshjeje.

Neni 6

Të ndryshme

- 6.1 Kjo Marrëveshjeje zbatohet dhe interpretohet sipas legjislacionit shqiptar në fuqi. Çdo mosmarrëveshjeje që mund të lindë lidhur me, ose nga kjo Marrëveshjeje do të zgjidhet nga Palët me mirëkuptim dhe në rast të kundërt, kompetente për zgjidhje do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

“San Luca” Sh.P.K.

L82009018B


Rruga “e Kavajës”, nr. 116, Tirana, Albania

Subscribed & Paid-In Capital: ALL 100.000,00

- 6.2 Kjo Marrëveshje përbën marrëveshjen e plotë të Palëve si dhe deklaratimet e plota dhe ekskluzive të kushteve dhe afateve të parashikuara në këtë Marrëveshje në lidhje me objektin e kësaj Marrëveshje. Kjo Marrëveshje zëvendëson të gjitha marrëveshjet apo mirëkuptimet e mëparshme, me shkrim apo me gojë, që mund të ekzistojnë midis Palëve lidhur me objektin e kësaj Marrëveshje, apo pjese të saj.
- 6.3 Nëse secila prej dispozitave të kësaj Marrëveshje është, apo do të bëhet e pavlefshme, pjesërisht apo tërësisht, vlefshmëria dhe legjitimiteti i dispozitave të tjera mbetet e pacenuar. Dispozitat e pavlefshme, në masën e lejuar nga ligji, do të zëvendësohen me dispozita të tjera të vlefshme dhe të zbatueshme të cilat duhet të jenë në përputhje me synimin dhe qëllimin e dispozitave që zëvendësojnë.
- 6.4 Kjo Marrëveshje hartohet në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe. Secila kopje përbën dublikatë të origjinalit, por së bashku ato përbëjnë një dhe të vetmen Marrëveshje, me vlerë të njëjtte secila.
- 6.5 Nga një kopje i jepet secilës Palë, një kopje ruhet pranë arkivit të Shoqërisë dhe një depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim.

SHITËSI

Z. Rezart Cenaj



BLERËSI

Z. Dritan Aliaj

